- Afatet e pagesës së taksës:
  - Për kategorinë "Biznes" ky detyrim mundet te paguhet me dy këste, kesti pare deri me 30 Qershor 2026, kesti dyte me 31 dhjetor 2026 ku te jene likujduar te gjitha detyrimet.
  - Për kategorinë "Familjarë", taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm, deri në ***datën 31.12.2026.***
  - Për mospagesë në afatin e caktuar për kategorinë biznese/institucione do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Neni 114 dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë ose 0.06 % shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer por jo më shumë se 12 muaj ose 365 ditë.
  - Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **30.04.2026.**
  - Zyra në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për administrimin e taksës së ndertesës, mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve, përditëson të dhënat në regjistrin qëndror të baza e të dhënave të pasurisë së paluajtshme (kadastra fiskale).
  - Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe e Pronës duhet të paraqesë pranë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore cdo certifikatë përdorimi dhe Leje Ndërtimi të përfunduar, me qëllim që taksimi i ndërtesës të jetë sa më i drejtë dhe i saktë.

- **Afatet e pagesës**: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst, deri me data **31.12.2026**.
- **Lehtësira fiskale** do të ketë vetëm për familjet që paguajnë taksën mbi tokën bujqësore deri më 31 Dhjetor 2026 do të kenë një zbritje prej 30 % ***(vetëm detyrimi i vitit 2026, pjesa e debisë do të paguhet 100%).***
- **Struktura e ngarkuar** për përllogaritjen vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore pranë Bashkisë Prrenjas dhe zyrat e tatim taksave pranë Njësive Administrative.
- **Afati i njoftimit** të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 30.04.2026.